

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9584, DATË 17.7.2006, “PËR PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA ME LIGJ”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është që nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, të bëhet e mundur përshtatja e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave (INSTAT), si institucion i pavarur pas miratimit të ligjit nr.17/2018, “Për statistikën zyrtare”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hyrja në fuqi e projektligjit do të sigurojë plotësimin e kuadrit ligjor në lidhje me ndryshimet në kompetenca dhe funksione që iu bënë pozitë Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave (INSTAT), të cilat hyjnë në fuqi me miratimin e ligjit nr.17/2018, “Për statistikën zyrtare”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimi i vetëm që sjell ky projektligj është përcaktimi përfundimtar i Institutit të Statistikave, si institucion i pavarur, fakt ky që kërkon ligjërisht rigrupimin e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMIT ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj do të bëjë në ligjin ekzistues 3 ndryshime të reja, përkatësisht:

1. Neni 1 parashikon që në pikën 1, të nenit 2, të ligjit ekzistues, të shtohet emërtimi “Instituti i Statistikave”, për shkak të statusit të ri të institucionit.
2. Neni 2 parashikon që në klasifikimin “D”, të lidhjes nr.1, që përmendet në pikën 4, të ligjit ekzistues, shtohet pika 12, “Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave, 0.6”, që është raporti përkatës i pagës së tij.
3. Neni 3 parashikon kohën e fillimit të efekteve financiare, nga data 1 janar 2019.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Zbatimi i projektligjit do të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT).

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Këshilli i Ministrave në bashkëpunim me specialistët e Institutit të Statistikave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikon kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kalimit të pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm nga kategoria II-a në raportin 0.6.

KËSHILLI I MINISTRAVE